

UDHËZIM
Nr. 37, Datë 10.07.2013

PËR
“MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE GJATË PËRPUNIMIT TË
SHENJAVE TË GISHTAVE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE”

Në mbështetje të shkronjës “F”, të pikës 1 të nenit 31, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;

UDHËZON:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të detyrueshme nga institucionet publike për mbledhjen dhe përpunimin e shenjave të gishtave të punonjësve për vërtetimin e prezencës në punë (hyrjen apo daljen nga institucioni).
2. Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin si vijon:
 - a) “Institucion publik” është kontrolluesi, i cili përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale të marra nga shenjat e gishtave.
 - b) “Punonjës” është subjekti i të dhënave personale që i përpunohen shenjat e gishtave.
3. Titullari i institucionit publik jep një vendim të arsyetuar mbi qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të shenjave të gishtave, masat e sigurisë që do të ndërmerren për përpunimin e tyre, kohën e ruajtjes dhe mënyrën e shkatërrimit ose ndryshimit të tyre, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.
4. Lejimi i këtij përpunimi nga institucionet publike bëhet vetëm pasi të jetë kryer njoftimi pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe të jetë marrë autorizimi përkatës.
5. Institucioni publik pajiset me autorizim pasi paraqet pranë Autoritetit të Komisionerit aktin e përcaktuar në pikën 3 të këtij Udhëzimi dhe çdo dokument tjetër shtesë në përputhje me arsyetimin e aktit.
6. Përpunimi i shenjave të gishtave kryhet vetëm në rastet kur nuk ekziston një mënyrë tjetër për arritjen e qëllimit të përcaktuar në këtë udhëzim.
7. Mbledhja e shenjave të gishtave jo domosdoshmërisht bëhet me pëlqimin e shprehur të punonjësit, pasi kjo e dhënë nuk jep informacion mbi të.
8. Pavarësisht parashikimit të bërë në pikën 7, në çdo rast të këtij përpunimi, institucioni publik merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur këto të dhëna në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Komisioneri, Udhëzimin Nr. 21, datë 24.09.2012

për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj", i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 22, datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël", i ndryshuar.

9. Çdo punonjësi të cilit i është mbledhur kjo e dhënë ka të drejtë që, pa pagesë, me kërkesë me shkrim, të marrë nga institucioni publik informacion mbi procesin e përpunimit të shenjave të gishtave si dhe qëllimin e përpunimit të tyre.

10. Çdo punonjës, në rastet kur pretendon se mbledhja dhe përpunimi i shenjave të gishtave është në kundërshtim me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet që të paraqesë ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

11. Në institucionin publik, kushdo që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

12. Institucioni publik që përpunon shenjat e gishtave, raporton një herë në vit pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi mënyrën e realizimit të këtij procesi.

13. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi nga institucioni publik, përbën shkelje të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Flora Çabej (Pogaçe)